

Njoftim për shtyp

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), z. Altin Dumani, në ushtrim të kompetencës së Komisionerit Publik, autorizoi z. Adnan Xholi, me funksion Drejtuesi i Seksionit Kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit në Prokurorinë e Posaçme, që ta përfaqësojë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankimit kundër vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Gjatë verifikimit të prezencës, kryesuesja e trupit gjykues bëri me dije se subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar depozitimin e provave të reja dhe pas marrjes së dakordësisë nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vendosi administrimin e tyre dhe ftoi palët në paraqitjen e qëndrimeve përfundimtare.

Drejtuesi i Seksionit Kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit në Prokurorinë e Posaçme, z. Adnan Xholi, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit dhe qëndrimeve të mbajtura në seancën e mëparshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve dhe gjetjeve në ankim, që lidhen kryesisht me kriterin e pasurisë dhe kontrollit të aftësive profesionale. Në përmbyllje të bisedimeve përfundimtare, z. Xholi kërkoi nga Kolegji që pas vlerësimit tërësor të çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ardiana Bera.

Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi kërkimin e përfaqësuesit të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale dhe i kërkoi trupit gjykues kohë shtesë për të ristrukturuar qëndrimin e saj. Por trupi gjykues, i konsultuar në dhomë këshillimi, rrëzoi kërkesën e mësipërme, si të pabazuar dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit të vijonte me paraqitjen e bisedimeve përfundimtare.

Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit pretendoi të kundërtën e bisedimeve përfundimtare, të parashtruara nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale. Ajo pretendoi se gjetjet mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë të pabazuara dhe se gjetja mbi aftësinë profesionale është artikuluar jashtë afateve të parashikuara për ankimin.

Trupi gjykues, pasi u njoh me qëndrimet e palëve, u tërhoq në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar, të cilin do ta shpallë, më datë 20.5.2025, ora 13:00.

Ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.